



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA



Për më shumë
MË SKENO



RAPORTI VJETOR 2022

Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!



INITIATIVE FOR AGRICULTURAL DEVELOPMENT OF KOSOVO
INICIATIVA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË SË KOSOVËS
INICIATIVA ZA POLJOPRIVREDNI RAZVOJ KOSOVA

Të gjitha të drejtat e rezervuara, IADK

Vushtrri, 2023

Ndjekja e bujqësisë për një prosperitet më të mirë

Të nderuar lexues,
Sektori agro-ushqimor është më i rëndësishëm se kurrë. Si një nga organizatat joqeveritare të bujqësisë më të mëdha në vend, qëllimi i **IADK-së** është të zhvillojë sektorin e bujqësisë duke mbështetur komunitetin me ngritjen e aftësive dhe ofrimin e granteve të nevojshme për rritje ekonomike, përmirësim të prodhimeve bujqësore, ulje të kostosë së prodhimit, rritjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë mjedisore.

Duke qenë një vit veçanërisht sfidues, viti 2022 solli shumë ndryshime të rëndësishme në përpjekjet për zhvillimin e **IADK-së** dhe për përfituesit tanë. Viti i lënë pas dhe kriza e vazhdueshme na kujtuan se është thelbësore të qëndrojmë të bashkuar drejt pabarazisë, varfërisë dhe mbrojtjes së burimeve tona natyrore. Shpresojmë se sektori i bujqësisë do të performojë shumë më mirë në vitin 2023 me një planifikim të mirë dhe zbatimin e duhur të projekteve të reja dhe ekzistuese. Qëllimi ynë i vazhdueshëm është të vazhdojmë të ofrojmë mundësi të reja në sektorin agro-ushqimor për qytetarët që u mundëson atyre të përballen me sfidat në komunitetet e tyre.

Jam i kënaqur që kemi sukses në punën e përbashkët me ekipin e shquar të **IADK-së**, së bashku me donatorët, partnerët dhe fermerët tanë po punojmë për të sjellë ndryshimet e nevojshme për pasur një komunitet i cili ka një qëndrueshmëri në nivel global.

Detajet e punës dhe progresit tonë mund të gjenden në faqet në vijim, kështu që, ju mund të shihni ndikimin tonë përmes projekteve dhe shërbimeve në sektor të ndryshëm të bujqësisë në Kosovë.

Sinqerisht i juaji,

Zenel Bunjaku

Drejtore Ekzekutive i IADK-së



Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK) është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2005. Misioni ynë është promovimi i zhvillimit socio-ekonomik të zonave rurale, zvogëlimi i papunësisë dhe krijimi i mundësive për gjenerimin e të ardhurave për njerëzit që jetojnë në zonat rurale.

PËRMBAJTJA:


Ku ishim ne	06
Puna jonë në numra	07
Projektet dhe Shërbimet	08
Sektori i Perimeve	10
Sektori i Pemëve	12
Sektori i Blegtorisë	14
Sektori i Bletarisë	16
Sektori i Përpunimit të Ushqimit.....	18
Sektori i Bimëve Mjekësore dhe Aromatike	20
Sektori i Agroturizmit Rural	22
Përfshirja Gjimore dhe e Minoriteteve	24
Digjitalizimi në Bujqësi	25
Vizita Studimore	26
Praktika dhe Punësimi i Studentëve	27
Projekti/Shërbimet e ofruara nga ne	29
Partneritetet Ndërkombëtare	30
Burimi i fondeve/të ardhurave	31
Mirënjohje	33





Ku ishim ne

IADK ka ofruar mbështetje në 17 komuna të Kosovës
(në disa me dy projekte ose më shumë).



Më kryesoret në 2022 :

Krahas rritjes tonë, ne vazhduam të fuqizojmë dhe përmirësojmë mirëqenien e fermerëve tanë:



454 Përfitues



10 Projekte &
7 Projekte / Shërbime



28 Punonjës
& 6 Praktikant
& Vullnetar



7 Donator
13 Partner

Puna jonë në numra

- **454** Përfitues.
- **323** Përfitues janë meshkuj ose 71%.
- **131** Përfituese janë gra ose 29%.
- **88** Përfitues janë të rinj (18-35 vj.) ose 19% të mbështetur me grante.
- **28** Biznese të reja janë themeluar.
- **116** Mundësi vetëpunësimi.
- **10** Biznese të udhëhequr nga Gratë.
- **33** Serra janë montuar.
- **2** Makineri për mbjelle në fushë të hapur.
- **31** Përfitues Fermer janë mbështetur në sektorin e blegtorisë.
- **40** Përfitues janë mbështetur në sektorin e pemëve.
- **5** Bletar janë mbështetur me pajisje për bletari.
- **1** Përfitues është mbështetur në sektorin e shpendarisë.
- **332** Inpute të ndryshme janë shpërndarë për të gjithë sektorët.
- **6** Sisteme solare të instaluar në stane.
- **2140** Këshilla direkte në terren.
- **151** Trajnime të realizuara AAP-së, 201 pjesëmarrës.

- **29** Trajnime për aftësi të buta, marketing dhe financa, 145 pjesëmarrës.
- **103** Kandidatë u certifikuan pas përfundimit të trajnimeve të AAP-së.
- **27** Trajnime teknike në bujqësi, 119 pjesëmarrës.
- **23** Praktikantë.
- **8** Studentë të punësuar.
- **40** Vizita studimore.

Publikimet:

- **1** Raport.
- **6** Broshura.
- **5** Fletëpalosje.
- **1** Artikull ndërkombëtar.
- **2** Video promovuese.

Gjenerimi i të ardhurave të përfituesit

- **111** Përfitues 0 - 1000€.
- **31** Përfitues 1,001 - 1,200€
- **47** Përfitues 1,201 - 1,600€.
- **125** Përfitues > 1600 €.

Shënim: Kjo përfaqëson të ardhurat e krijuara nga përfituesit për këtë vit.





Projektet dhe Shërbimet



Përmirësimi i punësimit dhe mundësive për gjenerim të të ardhurave në zonat rurale të Kosovës - **Brot für die Welt**.



Fuqizimi i të rinjve dhe grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në bujqësi dhe përpunim të ushqimit - **CFD**.



Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-Ekonomik të Komuniteteve Minoritare në Kosovë - **DRC**.



Fuqizimi i zinxhirit të vlerës së riciklimit në Mitrovicën Jugore - **DRC**.



Krijimi i vendeve të punës në bujqësi - **EU**.



Mbështetja në punësimin e të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë - **EU**.



Transhumanca - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi - **EU**.



Digjitalizimi i Shërbimeve Këshillimor Bujqësore - **Fairshare**.



Forcimi i zinxhirëve të vlerës përmes programit të zhvillimit të aftësive - **GIZ**.



Rritja e zhvillimit të aftësive në sektorin e përpunimit të ushqimit në Kosovë - **USAID**.



Shërbime profesionale të ofruara - **FAO, SWISS CONTACT, SOWI, EPI CENTER, SKAT dhe CARITAS**.

Sektori i Perimeve

Si organizatë, ne synojmë të ndihmojmë përfituesit tanë të arrijnë prodhim maksimal, të prodhojnë ushqim të shëndetshëm dhe të pasurojmë tokat tona pjellore.

Kosova, me kushtet e saj klimatike dhe vendndodhjen gjeografike ka një potencial të madh për kultivimin e llojeve të ndryshme të perimeve. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në Kosovë mund të grupohet në këto kategori: tokë bujqësore, e cila merr pjesë me 38,53%, pyje dhe tokë pyjore 44,11%, tokë urbane, 4,40%, dhe të tjera 12,96%.

Sipërfaqja e tokës së punueshme përfshin perimet në fushë të hapur si kulturë e parë (8,435 ha) dhe perime në serrë si kulturë e parë (547 ha) në vitin 2020 sipas Agjencisë Statistike të Kosovës. Kulturat kryesore të kultivuara janë drithërat: gruri dhe misri, perimet: specat, domatet, trangujt, patatet, fasulet, kungulli, lakra dhe qepa. Sipërfaqja e perimeve është rritur krahasuar me vitet paraprake nga të cilat IADK ka kontribuar në rritjen e sipërfaqesë për 0.6 ha serë në vitin 2022.

Ndërsa në total, ne kemi mbështetur 179 fermerë të vegjël nëpër komunat e sipërpërmendura me grante (fidane, sistem të ujitjes dhe makineri). Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, ne synuam t'i pajisim fermerët e vegjël me të mira dhe aftësi për të ndërtuar jetesë të sigurt, për të rritur qëndrueshmërinë, kosto efektive dhe për të mbrojtur burimet e tyre natyrore për të ardhmen.

Fermerët tanë të perimeve kontribuan në rritjen e prodhimeve bujqësore deri në 420 ton për të ushqyer njerëzit e komunitetit të tyre. Stafi ynë i fushës së hortikulturës po promovon në mënyrë aktive praktikën më të mirë të kultivimit duke trajnuar, këshilluar dhe monitoruar përfituesit në zonat rurale. Teksa shënojmë të ardhurat e vitit të kaluar, po theksojmë qëndrueshmërinë e fermerëve.



179
Fermerë
të mbështetur



861
Këshilla
direkte



3.5 ha
Perime
të kultivuara



7
Sesione
të trajnimit



105.000
Fidane të shpërndara
për fermer



10
Vizita
studimore



Sektori i perimeve



Në vitin 2022, prej shumë aplikuesve, ekipi ynë takoi Znj. Sadete Kasumin nga fshati Stanofc i Epërm, Komuna e Vushtrrisë. Sadetja ka 5 anëtarë të familjes dhe asnjëri prej tyre nuk ishte i punësuar; Familja Kasumi zotëron 20 ari tokë dhe me mbështetjen e IADK-së ka arritur të ketë serrën e saj prej 176m² me inputet përcjellëse dhe të fillojë të kultivojë domate dhe specat. Përmes serrës ajo ka arritur të prodhojë 2 ton perime dhe të ketë të ardhura deri në 1500 €, ndërsa në stinën e vjeshtës kultivon perime vjeshtore si sallatë dhe spinaq.



20 ari

.....



176m²

.....



2000 kg/vit



Sadetja thotë:

“Tani jam në gjendje të siguroj të ardhura për familjen time”



Sektori i Pemëve

Kosova ka burime natyrore për zhvillimin e bujqësisë, po ashtu edhe traditë në prodhimin e pemëve. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës në Kosovë është 421.080 nga të cilat me perimtaria zë një sipërfaqe prej 10.265 ha sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës. Pemët frutore kryesore të kultivuara janë molla, kumbulla, mjedra, dredhëza, rrushi dhe arra. Edhe pse ende ka vështirësi në organizimin e sektorit, megjithatë, pemtaria po shënon rritje drejt tregut dhe rritje të vlerës së shtuar të kulturave bujqësore. Konsolidimi i mundësive eksportuese dhe interesi i lartë i komunitetit për të konsumuar prodhimet vendore e të freskëta, ka mundësuar rritjen e interesimit të fermerëve për të mbjellë më shumë pemë në parcelat e tyre.

IADK përmes projekteve dhe shërbimeve të saj ka ofruar trajnime praktike dhe këshilla në praktikat e mira për përdorimin efikas të plehrave, teknika të avancuar të kultivimit dhe përdorimit racional të pesticideve që do të ndikojnë në uljen e ndotjes së mjedisit dhe përmirësimin e cilësisë dhe rendimentit. Për më tepër, u ngritën njohuri për krasitjen e gjelbër të pemëve, dhe përdorimin racional të ujit për të minimizuar humbjet e ujit.

Pavarësisht trajnimit, fermerët u mbështetën me grante të ndryshme, pra me fidane të dredhzës, makineri bujqësore, pajisje monitoruese dhe inpute shoqëruese në sektorin e mollës dhe mjedrës. U mundësua që fermerët tanë të kenë analiza të dheut për parcelat e tyre, u ofruar rezultatet dhe rekomandimet për fermerët dhe u udhëzuan fermerët rreth metodave dhe dozave të nevojshme për plehërim të pemëve të kultivuara.



120
Fermerë
të mbështetur



353
Këshilla
direkte



9
Sesione
të trajnimit



7
Vizita
studimore



Mbillni sot për të korrur nesër



IADK në aktivitetet e saj synon në vazhdimësi të rinjtë, njëri prej tyre është Patriot Kadriu i cili ka 3 ha tokë nga fshati Likoc, Komuna e Skenderajt. Patrioti u mbështet në vitin 2021 me (15 ari) fidane të dredhëzës të shoqëruara me sistem ujitje dhe plehra. Gjatë vitit 2022, ai kultivoi dredhëzën me sukses duke prodhuar sasi dhe krojoi të ardhura të konsiderueshme. Patrioti së bashku me familjen dhe punonjësit e tjerë të angazhuar sezonalë ka vjelur 2300 kg dredhëza dhe ka realizuar të ardhura prej 3,450 €. Synimi i tij është rritja e sipërfaqes me dredhëz për sezonin e ardhshëm deri në 0.5 ha.



15 ari



2300 kg/vit



Patrioti thotë:

“Dredhëzat tona të shijshme janë direkt të freskëta nga ferma”



Sektori i Blegtorisë

Blegtoria ka një potencial shumë të rëndësishëm për avancimin dhe zhvillimin e industrisë bujqësore. Kosova ka peizazhe unike të ofruara nga malet dhe sipërfaqe të mëdha të mbuluara me pyje. Burimet natyrore (uji, toka dhe ajri) janë nën presion të ulët për shkak të menaxhimit ekstensiv të tokës bujqësore (inputet të ulëta kimike, dendësia e ulët e kullotjes dhe fermat e kufizuara intensive të blegtorisë).

Pavarësisht se ka potencial të lartë për të zhvilluar sektorin e blegtorisë, ka sfida të shumta: potenciali i dobët gjenetik i racave të përdorura, fermat e pamodernizuara, menaxhimi joefikas i fermës, si dhe fermerët e vjetër të përfshirë në mbarështimin tradicional që nuk zëvendësohen nga brezi i ri, barrierat administrative dhe logjistike për eksport etj. Prodhimi blegtoral përbën një komponent shumë të rëndësishëm të ekonomisë bujqësore të vendeve në zhvillim, një kontribut që shkon përtej prodhimit të drejtpërdrejtë të ushqimit për të përfshirë përdorime për shumë qëllime, si lëkurat, fibrat, plehrat dhe karburantet, si dhe akumulimin e kapitalit.

Në nivel ferme, paratë e gatshme mund të gjenerohen rregullisht nga shitja e drejtpërdrejtë e produkteve blegtorale, si qumështi, vezët dhe pleh organik, herë pas here nga shitja e kafshëve të gjalla, leshi, mishi dhe lëkura. Bazuar në të dhënat e Agjencisë Statistike të Kosovës, gjedhët janë kategoria kryesore në sektorin e blegtorisë, numri i tyre është 261,389 ose 47.5%. Deri në vitin 2020, lopët qumështore përbëjnë 51% të numrit të përgjithshëm të gjedheve me prodhimin prej 281 mijë litër qumësht, dele dhe dhi përbëjnë 43,9% ose 241,688 krerë, ndërsa sektori i derrave nuk është aq i zhvilluar me vetëm 45,384 krerë. Sektorin e shpendarisë është i vetmi sektor që plotëson nevojat e konsumit të Kosovës, gjithsej 366 milionë vezë janë prodhuar nga 2,782 pula (000').

IADK është e përkushtuar të përmirësojë kontributin e sektorit të blegtorisë në zhvillimin e qëndrueshëm përmes programit të AAP "Teknik i Blegtorisë" niveli III sipas KKK, granteve dhe shërbimeve këshillues. Qëllimi ynë është të përmirësojmë shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, gjë që do ta bëjë procesin e prodhimit shumë më efikas dhe fitimprurës për fermerin, ndryshimi i përzierjes ushqimore do të mundësojë rritjen e sistemit imunitar dhe për të ndihmuar kafshët të prodhojnë më shumë, të përmirësojnë sigurinë ushqimore, të zvogëlojnë rreziqet e antimikrobikëve, rezistencë dhe menaxhim më i mirë i plehut organik.



9
Sesione të
trajnitimit në AAP



20 nga 30 Kandidat
morën certifikata
valide nga AKK



66 Përfitues
të blegtarisë &
2 të Shpendarisë



370
Këshilla
direkte



4
Vizita
studimore



Sektori i Blegtorisë



Enis Jashari është një fermer i vogël nga Vojnoci, Komuna e Shtimes, i cili zotëron 5 ha tokë dhe ka 10 lopë qumështore në fermën e tij. Ai vendosi për t'u bërë një fermer i suksesshëm në sektorin e blegtorisë duke kultivuar grurë dhe misër, jo vetëm në tokën e tij, por duke marrë 25 ha më shumë me qira në fshatrat e afërta. Ai ishte pjesë e programit të AAP-së, si Teknik i Blegtorisë, ku mësoi për aspekte të ndryshme të menaxhimit të fermës duke përfshirë përzgjedhjen e kafshëve qumështore, higjienën, ushqyerjen, mbarështimin dhe menaxhimin e lopëve qumështore. Andaj ai u mbështet me mekanizëm bujqësor dhe shërbime këshilluese nga ekipi i IADK-së. Enisi thekson se nga mësimet e marra dhe përfitimi i grantit ka rritur motivimin për të zgjeruar aktivitetet e tij në fermë, për të përgatitur racionet të reja ushqimor që e ka arritur atë të rrisë sasinë dhe cilësinë e qumështit, të reduktojë shpenzimet dhe të rrisë fitimin.



5 ha



+25 ha



Enisi thotë:

“Shëndeti është i balancuar me cilësinë e mirë të qumështit”



Sektori i Bletarisë - Sektori ynë i ëmbël

Kosova është shumë ekologjike për zhvillimin e bletarisë dhe prodhimin e mjaltit cilësor, kjo për shkak të përdorimit të ulët të pesticideve dhe florës së pasur. Bletaria ka pasur zhvillim vitet e fundit, sipas statistikave të ASK-së në vitin 2020 janë 262,541 shoqëri bletësh, ndërsa, pavarësisht vështirësive në ndryshimet klimatike është mundësuar prodhimi i mjaltit për 1,040 ton për konsum vendor.

Faktorë të shumtë kontribuojnë në kërcënimet e mbijetesës së bletëve:

- Ndryshimet klimatike
- Humbja dhe fragmentimi i habitatit
- Bimët dhe bletët pushtuese
- Diversiteti i ulët gjenetik
- Patogjenët e përhapur nga bletët e menaxhuara në mënyrë komerciale
- Pesticidet

Kërkesat për mjaltë vendor e më cilësi janë shumë të larta në tregun vendas, prandaj edhe çmimet janë më të larta se në vendet e BE-së. Bletët kanë nevojë për nektarin si burimin kryesor të ushqimit. Bimët vendase, të cilat janë përshtatur me tokat dhe klimën lokale, janë burimet më të mira të nektarit dhe polenit. Shumica e bimëve vendase janë lehtë të mirëmbajtshme dhe nuk kanë nevojë për ujtime ose plehra. Ne synojmë të adresojmë sfidat me të cilat përballen bletarët në ruajtjen e shëndetit të bletëve dhe bletarisë. Këshilltarët tanë të bletarëve kanë ofruar këshilla teorike dhe praktike në bletishte mbi teknikat e praktikave më të mira për menaxhimin, zhvillimin e shumimin e bletëve, njohja dhe kontrolli i sëmundjeve. Gjithashtu, bletarët u këshilluan për higjienën e koshereve, ushqimin e bletëve, trajtimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve të bletëve, trajtimin dhe menaxhimin si dhe përdorimin e pajisjeve të bletarisë.



13 Bletar
të mbështetur
me grante



20 Bletar
të mbështetur
me këshilla direkte



1445 kg
Mjaltë
e vjelur



26,000.00€
të ardhura
nga shitjet



2
Vizita
studimore



Sektori i bletarisë



Znj. Ganimete Peci është një nënë e katër (4) fëmijëve, bletërritëse krenare nga fshati Zhazh, komuna Zveçan. Çdo ditë ajo zgjohet në zhurmën e bletëve të saj, të cilat rriten e zhvillohen në një lartësi prej 840 m, ajo filloi punën e saj në vitin 2016 me vetëm 5 shoqëri bletësh ndërsa aktualisht ajo zotëron 73 të tilla, me një prodhim të përafërt mjalti deri në 12 kg për shoqëri bletësh. Për të lehtësuar punën, IADK ka mbështetur Ganimeten me shoqëri bletësh dhe pajisje të nevojshme për vjeljen, ruajtjen e mjaltit dhe përpunimin e dyllit. Ajo shprehet me kënaqësi se rendimenti dhe shitjet e saj janë rritur dhe se kërkesat e tregut janë aq të larta sa konsumatori gjithmonë porosin mjaltin paraprakisht.



73 copë

.....



12 kg/shoqëri



Ganimetja thotë:
“Mjalti ynë është Ari”



Sektori i Përpunimit të Ushqimit

Përpunimi i ushqimit është shndërrimi i produkteve bujqësore në ushqim. Objektivi parësor i ruajtjes së ushqimit është parandalimi i prishjes së ushqimit derisa të mund të konsumohet, prandaj përpunimi i ushqimit na ofron mundësinë që të kemi shumëllojshmëri më të madhe produktesh gjatë gjithë vitit. Përfitimet kryesore të përpunimit të ushqimit janë: garantimi i sigurisë së ushqimit, përmirësimi i shijes dhe teksturës, reduktimi i mbetjeve ushqimore, përshtatja me nevojat specifike, pasurimi dhe prodhimi i alternativës së qëndrueshme. Tradita jonë në përpunimin e ushqimit e plotësuar me kërkesën e lartë për produkte rurale është vazhdimisht në rritje ditë-ditë. Departamenti i përpunimit të ushqimit në IADK është shumë i përkushtuar për të forcuar sektorin në kuadër të programeve të AAP-së të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimit në konservimin e frutave dhe perimeve, përpunim të qumështit dhe produkteve të ëmbëlsirave. Programet e trajnimit përbëhen nga pjesa praktike 70% dhe zhvillohen në qendrën e njësive të përpunimit të ushqimit në IADK.

Objektivat e strategjisë sonë janë të përqendruara në fuqizimin e grave të angazhuara në sektorin e përpunimit të ushqimit sektor ky i cili drejtohet kryesisht prej tyre. Krahas trajnimit të arsimit dhe aftësisht profesional, IADK-ja i ka mbështetur këto gra me pajisje për përpunim, etiketim të produkteve, marketing digjital dhe regjistrim të biznesit.



AAP (Arsim dhe Aftësim Profesional)



112
Sesione
trajnimi në AAP



126 Gra/Vajza
Kanë qenë pjesë e
trajnitimit të AAP-së



40 nga 72
Morën certifikata
valide nga AKK



10
Njësi
përpunuese
të krijuara



3 Njësi
Përpunimi të frutave
dhe perimeve



1 Njësi
Përpunimi të
qumështit



5 Njësi
Ëmbëlsirash



1 Njësi
Ushqimore tradicionale



56 Gra/Vajza
Të mbështetura me
pajisje të vogla



90
Këshilla
direkte në njësi



7
Vizita
studimore



Sektori i Përpunimit të Ushqimit



Jeta nuk ka qenë aq e lehtë për Nerxhivane Krasniqin, e lindur dhe e rritur në fshatin Zhilivodë të Komunës së Vushtrrisë. Edhe pse jetonte 20 km larg qytetit, Nerxhivania ishte shumë e përkushtuar për të vazhduar më tej arsimimin e saj dhe gjetjen e mundësive më të mira. Ajo ishte pjesë e trajnimit të arsimit profesional në sektorin përpunues, u shpërblye nga IADK si një nga gratë e suksesshme e mbështetur me grant. Ajo përfitoi pajisje për ruajtjen e lëndës së parë dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve. Nga trajnimet dhe pajisjet e përfituara tani ajo thotë se është shumë më e sigurt për jetëgjatësinë e produktit. Produktet e saj kryesore shtëpiak Turshi, Reçel dhe Ajvar mund t'i gjeni në tregjet dhe panairët lokale.

Resmije Hyseni, përfituese e pajisjeve të pastičerisë nga fshati Oshlan, ka qenë gjithmonë e njohur për ëmbëlsirat e saj të shijshme në vendin ku jeton. Industria ushqimore ka qenë relativisht në rritje njëkohësisht me kërkesën lokale në qytetin e Vushtrrisë. Resmija, pronare dhe pastičiere, është një grua ambicioze me shumë përkushtim dhe pasion; ajo është trajnuar dhe zhvilluar aftësitë e saj në pastičeri duke ndjekur programin e ëmbëlsirave në IADK. Më pas ajo u zgjodh si një nga përfitueset e njësive përpunuese, ajo regjistroi biznesin e saj “Dina’s Cake”, klientët blejnë produktet e saj në raste të tilla si ditëlindje, dasma, përvjetorë dhe festime të tjera. Kërkesa është aq e madhe sa ajo ka bërë marrëveshje kontratë me restorante të qytetit. Tani e gjithë familja është e angazhuar në biznes të cilët kanë mbështetur për të hapur një dyqan të vogël në qytet, në mënyrë që klientët të gjejnë lehtësisht produkte cilësore të prodhuar nga Dina, gjë që tregon se biznesi i saj vazhdimisht po rritet dhe po zhvillohet.



Nerxhivani thotë:

“Kisha shumë ëndrra të cilat mendoja se nuk do të realizoheshin kurrë, edhe pse të jetosh në një zonë rurale ka shumë vështirësi, nuk më ka penguar kurrë të vazhdoj më tej dhe me mbështetjen tuaj tani është shumë më e lehtë.”



Resmija thotë:

“Ëmbëlsirat, ëmbëlsuan jetën tonë”

Sektori i Bimëve Mjekësore dhe Aromatike

BMA-të janë një nga sektorët më të suksesshëm në bujqësinë e Kosovës. Produktet bujqësore organike nga Kosova ofrojnë potencial të mirë eksporti dhe gjithashtu një shumëllojshmëri të konsiderueshme të lëndëve të para të certifikuara si produkte organike, kompanitë evropiane po shfrytëzojnë potencialin e tregjeve ndërkombëtare për këtë qëllim, kështu duke krijuar vende pune në Kosovë, veçanërisht në zonat rurale. Kërkesat e tregut ndërkombëtar dhe çmimet e larta kanë rritur interesin e fermerëve për të zgjeruar zonat me produkte organike. Kushtet agroklimatike, tokat pjellore, tregon se 1.672 ha janë parcela organike sipas të dhënave të vitit 2020 nga MBPZHR, duke mundësuar eksport të produkteve deri në 8.9 milionë euro.

BMA-të mund të vjelen si bimë të tëra ose në pjesë të caktuara ku substancat aktive janë më shumë (lulet, gjethet, rrënjët dhe kërcelli, frutat, farat, lëkura, degët, sythat, etj.), sistemi i prodhimit është ambientalist dhe kulturat kryesore të kultivuara janë renditur në tabelën e mëposhtme.

Llojet	Sasia/ton
Kamomil (<i>Matricaria chamomilla</i>)	130
Hithra (<i>Urtica dioica</i>)	45.5
Menta (<i>Mentha piperita</i>)	40.7
Rigoni (<i>Origanum vulgare</i>)	36.9
Mullagë e zakonshme (<i>Malva sylvestris</i>)	11.7
Luledielli (<i>Helianthus annuus</i>)	4.6
Kalendula mjeksore (<i>Calendula officinalis</i>)	4.1
Ciani (<i>Centaurea cyanus</i>)	3
Melisa (<i>Melissa officinalis</i>)	2



Shënim: Prodhimtaria e bimëve mjekësore dhe aromatike në Kosovë në vitin 2020

IADK ka vazhduar me trajnime dhe shërbime këshilluese për të përmbushur standardet e larta të cilësisë me përfituesit e vitit të kaluar të mbështetur me fidanë të BMA-ve, tharëse natyrale, sistemin e ujitjes, mekanizmin dhe inputet shoqëruese. Gjatë procesit të mentorimit fermerët janë këshilluar lidhur me teknikat dhe pajisjet e prodhimit të fidanëve, substratin e fidanëve, menaxhimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, plehërimin dhe ujitjen e fidanëve, përgatitjen e tokës dhe procesin e mbjelljes. Përveç kësaj me partnerët tanë u organizuan trajnime lidhur me identifikimin e bimëve helmuese në sektorin e BMA-ve, prodhimin organik të perimeve dhe pemë të imta dhe menaxhimin e plantacioneve organike. IADK ka plotësuar të gjitha kriteret e AKK-së për të pasuruar programet e saj të AAP-së me BMA dhe produkte pyjore jodrusore dhe nga viti i ardhshëm kandidatët mund të ndjekin programin e validuar.



6
Ditë
trajnim



90
Fermerë të BMA
janë këshilluar



390
Vizita të fermerëve
Vizit në fushë



4
Vizita
studimore



Sektori i bimëve mjeksore aromatike



Florije Dreshaj së bashku me familjen e saj gjashtë (6) anëtarëshe jeton në fshatin Vrellë, Komuna e Istogut. Për Florijen, bujqësia, veçanërisht grumbullimi i bimëve mjeksore dhe aromatike është burimi kryesor i të ardhurave, pasi asnjë nga familjarët e saj nuk është i punësuar. Sigurimi i të ardhurave të tyre vetëm nga ky aktivitet ishte shumë sfidues për ta. Me qëllim që Florija dhe familja e saj të gjenerojnë të ardhura më të larta dhe të përmirësojnë gjendjen e tyre financiare, ata filluan të kultivojnë vetë Kalendulë dhe Mullg të zezë dhe t'i shesin ato të freskëta ose të thata në qendrat e grumbullimit. Për Florijen, trajnimet, granti këshillat direkte nga IADK e kanë ndihmuar që të ketë sukses në udhëheqjen e këtij sektori. Tani ajo prodhon cilësi dhe sasi të lartë të BMA-ve, të cilat nga ana tjetër rezultuan në të ardhura për familjen e saj. Florije nga toka e saj prej 30 ari arri të vjel 24 kg kalendula të thata dhe 166 kg mullag të thatë dhe të gjenerojë të ardhura prej 1972 € për vitin 2022.



30 ari



1972.00 €/vit



Florija thotë:

“Kultivimi organik siguron tokë më të shëndetshme”



Sektori i Agroturizmit Rural

Ekonomia rurale ka mundësi të zhvillohet duke llogaritur në burimet natyrore (të tilla si tokat pjellore dhe pyjet e gjera), peizazhet e bukura dhe traditat në përpunimin e ushqimit, në harmonizim me kërkesat në rritje për produkte tradicionale dhe turizmit rural.

Banorët vendas kanë siguruar ngritjen e staneve (kasolleve) në malet e tyre të origjinës. Stanet, nënkuptojnë strehimoret verore të barinjve në lartësi më të larta, stanet ku barinjët lëvizin gjatë muajve të verës për të kullotur bagëtinë e tyre, ku me zhvillimin e turizmit malor, shërbejnë edhe si një pikë pushimi për turistët vendas dhe ndërkombëtarë. Stanet, kanë një arkitekturë specifike, tradicionale dhe ndodhen në zonat malore më atraktive.

Për të kontribuar edhe më shumë në zhvillimin e turizmit rural, IADK ka mbështetur stanet malore me sisteme solare diellore, kampingjet që u shërbejnë adhuruesve të natyrës për të kaluar natën, pika pushimi për të përjetuar shijen e produkteve bio dhe tradicionale ashtu siç vetëm banorët e kësaj ane dinë të sjellin, si dhe aktivitete që lidhen me ngritjen e kapaciteteve dhe aktivitete promovuese. Qëllimi është krijimi i kushteve që ata të mund të ofrojnë shërbime turistike për të tjerët.





Sektori i Agroturizmit Rural

IADK në partneritet me AZHR dhe komunat ka krijuar një shteg tematik dhe sinjalistikë përgjatë shtegut që lidh stanet me zonën kufitare të Kosovës dhe Malit të Zi.

Bjeshkët e Istogut gjenden në vargmalet e Bjeshkëve të Nemuna, në veriperëndim të Kosovës, që do të thotë se janë vazhdimësi e këtij masivi. Shtegu ndërkufitar (pjesë e shtegut Via Dinarica), i cili kalon ndërmjet Istogut dhe Pejës, është rreth 100 km i gjatë, i cili fillon në lartësinë mbidetare 1814m nga Mokna në Sejnove dhe më pas nga Sejnova që çon Istogun në Hajl të Pejës. Përgjatë këtyre kemi shtigje të tjera të cilat njihen si shtigje lokale. Rajonet më të njohura të këtij masivi janë: Mokna, Bjeshka e Thatë, Gurrat e Bardhë, Lugu i Butë, Koreniku, Corrovoda, Bajshet, Jerebia, Radusha etj. Kjo zonë ka filluar të vizitohet çdo vit nga shumë turistë për shkak të bukurive të rralla malore. Me pamje të ndryshme, si mure shkëmbore, livadhe plot ngjyra, pyje ahu dhe pisha të gjelbra të larta, burime me ujë të ftohtë, e pasurojnë edhe më shumë këtë zonë, duke dhënë shpresë për zhvillim edhe më të madh të agro turizmit.

Në këto shtigje të gjithë mund të gjejnë veten, për shkak të zonës së butë malor, kjo zonë është e përshtatshme për aktivitete të tilla si ecja në mal, via ferrata, eksplorimi i shpellave, vrapimi malor, çiklizmi dhe kalërim. Shtegu i themeluar do t'ju çojë tek përfituesja jonë Emine Kabashi në masivin e Jerebisë të fshehur brenda maleve të Istogut. Familja Kabashi së bashku gjatë transhumancës shpenzon deri në 130 ditë së bashku me bagëtinë dhe turistët e tyre. Një nga vështirësitë me të cilat përballen është mungesa e energjisë elektrike, me mbështetjen e IADK-së me pikë pushues dhe panele solare jo vetëm që mund të qëndrojnë më gjatë gjatë natës, por e përdorin rrymën edhe për të mjelur bagëtinë. Emine thot se çdo turist që do të vizitojë stanin e tyre do të mund të shijojë ushqimet e saj tradicionale (Flija, leçenik, produkte bylmeti shtëpiake etj.), të ëmbëlsuar me reçelin e frutave të egra dhe çajra të pyllit.



Eminja thotë:
“Kur ki dritë, i ki tanat”



Përfshirja gjinore dhe e minoriteteve



Dhuna me bazë gjinore mbetet një nga shkeljet më të shpeshta të të drejtave të njeriut në mbarë botën. Ne jemi fokusuar në çështjen e dhunës me bazë gjinore përmes aktiviteteve tona të ndryshme për të pasur ndikim në fuqizim në aspektin social dhe ekonomik. IADK është bashkuar kampanjës globale të aktivizmit 16-ditor kundër dhunës me bazë gjinore dhe Ditës Ndërkombëtare të Gruas dhe Ditës së Gruas Rurale. Ekipi ynë së bashku me grupin tonë joformal të grave dhe vajzave kanë zhvilluar aktivitete të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin e publikut, forcimin e rolit të gruas dhe përdorimin e të drejtave të tyre. Aktivitetet tona u zhvilluan me akterët kryesorë si zyrat komunale, policia, përfaqësuesit gjinorë, strehimoret e grave dhe shoqata të tjera.

IADK ka forcuar zinxhirin e vlerës së riciklimit në lagjen e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Mitrovicën Jugore. Për përmirësimin e grumbullimit-përpunimit të mbetjeve, brenda zonës së banimit të komunitetit, është investuar në modernizimin dhe funksionalizimin e objektit të riciklimit, mbështetje me pajisje riciklimi, pajisje elektronike, shërbime këshillimore për linjën e përpunimit të mbetjeve dhe menaxhimin e financave.




Dixhitalizimi në bujqësi

Ne përdorim mediat sociale për të komunikuar me grupet tona të synuara, për arsye se ne duam të bëjmë më shumë për fermerët sesa thjesht t'i informojmë ata. Dixhitalizimi i ofron fermerëve tanë mundësi të jashtëzakonshme dhe forma të reja të qasjes: me një telefon të mençur dhe çasje në internet, ata mund të dinë çmimet që mund të presin nga prodhimet e tyre, të marrin këshilla teknike, të marrin trajnime të mëtejshme, të lidhen me njëri-tjetrin, të jenë aktivë dhe të ofrojnë zgjidhje lokale dhe inovative.


Përmes një rasti specifik që ne po zbatojm, ne po përmirësojmë dixhitalizimin e Shërbimit Këshillimor Bujqësor për:

1. Monitorim i zhvillimit të bujqësisë në kohë reale;
2. Rreziqet për fushë bazuar në të dhënat e motit dhe të dhënat satelitore;
3. Identifikimi i kursimeve të mundshme të kostove;
4. Profiti sipas fushës, kulturës dhe varietetit;
5. Shpërndarja e automatizuar e kostos së makinës sipas orëve;
6. Konsumi i karburantit për tokë sipas udhëzimeve të punës;
7. Monitorimi automatik i temperaturës, lagështisë dhe shpejtësisë së erës.

Dixhitalizimi është i dedikuar kryesisht për fermerët, por gjithashtu edhe për këshilltarët, ai do të mbulojë sektorët kryesorë të bujqësisë dhe nën-bujqësisë që janë të zhvilluara mirë në Kosovë siç janë pemëtaria, blegtoaria, bimët mjekësore dhe aromatike, dhe perimet. Për më tepër, IADK në bashkëpunim me FAO ka bërë një vlerësim për bujqësinë digjitale, gjininë dhe rininë në Kosovë në zonat rurale për gjithëpërfshirjen ekonomike, rezultatet dhe rekomandimet për zhvillim të më tutjeshëm i janë prezantuar MBPZHR-së.



ID	Country	City	Forward status	Status start date	Fields	Crops	Actions
1	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
2	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
3	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
4	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
5	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
6	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
7	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
8	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
9	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍
10	Albania	Prishtine	Monitoring activated	11/21/2021	1 ha	1 Field	🔍 📊 📅 📍





Vizita studimore dhe panaire

Të mësosh gjëra të reja është shumë sfidë; është gjithmonë e vështirë të shihet se si të mësuarit lidhet me praktikatat reale. Vizitat e shkëmbimit janë një mënyrë e përshtatshme për të lidhur temat me problemet e jashtme. IADK me qëllim të rritjes së kapaciteteve të fermerëve, të trajnuarve dhe stafit organizon vizita të ndryshme studimore për të bashkërenduar njohuritë dhe ekspertizën.

Objektivi ynë është të përvetsojmë dhe krijojmë mundësi duke zgjeruar horizontet përmes shkëmbimit teknik dhe modelit të fermave dhe NVM-ve në një spektër të gjerë agro-ushqimor. Vizitat lokale dhe rajonale përfshijnë ferma të vogla familjare dhe komerciale në shkallë të gjerë; panaire, interesa specifike në kultura, blegtori, qumësht, fruta, perime, serrat së bashku me bujqësinë precize, fabrikat e automatizuara.

Me qëllim të promovimit të produkteve vendore në komunitet, IADK ka organizuar panaire me përfituesit tanë në mënyrë që konsumatori vendor të blejë dhe shijojë produktet e fermerëve tanë dhe NVM-ve.

Vizita ndërkombëtare të stafit të IADK-së janë realizuar në Gjermani dhe Slloveni me qëllim që shkëmbimi ndërkombëtar kulturor dhe teknik të luajë një rol kyç në përmirësimin e programeve tona të AAP-së, trendeve agroushqimore dhe dixhitalizimit të bujqësisë.



40
Vizita studimore
të organizuara



525
Pjesëmarrës



271 ose 52%
ishin gra/vajza



250 ose 48%
ishin burra/djem



2 Sektorin
e bletarisë



10 Sektorin
e frutave



7 Sektorin
e perimeve



7 Sektorin
e përpunimit



4 Sektorin
e blegtorisë



4 Sektorin
e BMA




1 Sektorin e
agroturizmit
rural



3 Vizita
regionale



2 Vizita
internacionale



Praktika dhe Punësimi për Studentët

Ekonomikisht, punësimi u siguron të ardhura familjeve, ringjall kërkesën e brendshme për mallra dhe shërbime dhe stimulon rritjen e përgjithshme. Në aspektin social, punësimi mund të nxisë gjithashtu përfshirjen social, të inkurajojë kthimin e personave të zhvendosur dhe të përmirësojë mirëqenien sociale në periudha afatgjate.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla e papunësisë në Kosovë ka rënë në 20.70% në vitin 2021 nga 25.90% në vitin 2020, edhe pse me trende pozitive shkalla e papunësisë është ende shumë e lartë.

Kushdo me aftësi të mira arsimore mund të japë një kontribut në tejkalimin e papunësisë. Kjo është arsyeja pse IADK mbështet punën praktike të studentëve në fushën e bujqësisë dhe teknologjisë ushqimore. Qëllimi nuk është vetëm të ndërtojmë një karrierë individuale, por të kontribuojmë për t'u bërë punëtor profesionist dhe për të mbështetur zhvillimin e industrisë sonë bujqësore dhe ushqimore.

Në vitin 2022 kemi mbështetur 23 praktikantë për të rritur kapacitetet e tyre në fushën e tyre të studimeve. Prioritet iu dha aplikimeve nga të rinjtë e diplomuar të cilëve u mungonte përvoja e mëparshme e punës. Përveç kësaj, praktikantët u mbështetën me trajnime për aftësitë e buta në mënyrë që të përgatiteshin mirë për sfidat e tyre të reja.

Qëllimi ynë po arrihet: 8 nga 23 ose 35% e praktikantëve kanë nënshkruar marrëveshje punësimi, për të punuar në fabrika të Ushqimit dhe Bujqësore, institucionet qeveritare dhe OJQ-të.

Pjesë e ekipit tonë këtë vit ishin 3 studente nga Gjermania, Irlanda dhe Finlanda angazhuar përmes programit Erasmus, të cilat na mbështetën gjatë zbatimit të projekteve tonë dhe shkëmbimit të përvojave të tyre në fushën e bujqësisë dhe menaxhimit të rreziqeve nga fatkeqësitë.



23 Student
të angazhuar në
praktikë



18
prej tyre
gra/vajza



5
prej tyre
burra/djem




8
student janë
punësuar



35%
Shkalla e suksesit
në punësim



Praktika dhe Punësimi për Studentët



Unë Blerta Nishori, së bashku me kolegen time Fitoren e kemi ditur që donim të bënim punë praktike që kur ishim në fillim të studimeve, por nuk ishim të sigurt se ku, apo në çfarë cilësie. Më pas, në rrjetet sociale pamë një thirrje për mundësi praktike përmes IADK-së. Ne u inkurajua shumë sepse mendova se kjo do të ishte një mundësi e mirë për të rritur përvojën e punës. Pas përzgjedhjes së suksesshme, aftësitë tona të buta janë përmirësuar përmes trajnimeve të IADK-së, të cilat kanë pasur një ndikim shumë pozitiv në vendin tonë të punës. Ndërsa hulumtuam kompanitë e mundshme, të dyja kemi zgjedhur të realizojmë punën praktike në kompaninë LB Group në Lipjan, në cilësinë e teknologes së ushqimit, ku merremi me prodhimin e ëmbëlsirave. Në këto role, ne ishim në gjendje të ndihmonim në zhvillimin e produkteve të reja dhe ekzistuese brenda linjës së përpunimit të ëmbëlsirave, të siguronim përmbushjen e standardeve të sigurisë ushqimore, testimin dhe ekzaminimin e mostrave. Me dëshirë vinim në punë çdo ditë dhe kishim një ndjenjë rëndësie në atë që po bënim. Gjatë praktikës sonë 3 mujore patëm eksperiencat nga më të ndryshme, arritëm të kalonim nga student në profesionist. Angazhimi ynë është shpërblyer, tani jemi të punësuar si teknologe të ushqimit në LB Group.

Unë do t'i këshilloja kolegët studentë që kërkojnë punë praktike të kërkojnë mundësi të reja për të arritur përvojë profesionale, në mënyrë që të jenë të gatshëm kur të paraqitet mundësia e punës.



Shërbimet e ofruara nga ne

Hulumtim

- PPSE – Promoting Private Sector Employment angazhoj IADK për lehtësimin e intervenimeve në sektorin e UPN. IADK ka identifikuar ndërmjarjet e vogla dhe të mesme (NVM) me potencial në prodhimin e kontraktuar, zhvillimin e produkteve dhe shërbimet e marketingut dixhital për NVM-të.
- PPSE – Promoting Private Sector Employment angazhoj IADK për, Zgjidhje Alternative të Energjisë për Bujtina, Vlerësimin e tregut dhe identifikimin e bujtinave të interesuara, vlerësoj procesin e instalimit të zgjidhjeve energjetike në bujtina.
- Food and Agriculture Organization (FAO), IADK ka realizuar një vlerësim mbi bujqësinë digjitale, gjininë dhe rininë në Kosovën rurale për gjithëpërfshirjen ekonomike.

Trajnim profesional dhe mbështetje me grante

- Programi i Menaxhimit të integruar të Burimeve Ujore (IWRM) Program, financuar nga SDC, kontrakti IADK të zgjedhë sektorin më potencial për ndërhyrje dhe për të trajnuar fermerët në praktikën më të mira bujqësore. Si rezultat, 76 fermerë kanë rritur njohuritë për uljen e presionit që vjen nga bujqësia si pasojë e keqpërdorimit të plehrave, pesticideve dhe ujit. Vitin e ardhshëm, ata do të mbështeten me analiza të tokës, pajisje për monitorim të të dhënave për reshje dhe grante sipas kërkesave të fermerëve.
- SOWI Kosovo LLC në kuadër të projektit të erës Bajgora kontrakti IADK për të mbështetur 40 persona të prekur nga projekti duke ofruar programe të zhvillimit të aftësive, zhvillimit të planeve të biznesit dhe paketës së granteve të vogla.

Konsulenca

- Caritas Switzerland mandated IADK Caritas-i i Zvicrës kontrakti IADK-në për të ofruar shërbime për projektin Zhvillimi Ekonomik Rural i Qëndrueshëm dhe Gjithëpërfshirës (SIRED). Shërbimet e ofruara në fushën e mbështetjes teknike, zhvillimin e sistemit të tregut, monitorimin dhe matjen e rezultateve, zhvillimin e kapaciteteve dhe këshillimin për bujqësinë organike dhe certifikimin, si dhe vlerësimin e aplikantëve për grante.

Partneritetet Ndërkombëtare

IADK bashkëpunon me shumë partnerë lokal dhe ndërkombëtarë për të mbështetur sektorin dhe për të përmirësuar ofrimin e produkteve dhe shërbimeve të akterëve të ndryshëm.

Me qëllim të zhvillimit të shërbimeve këshillimore profesionale në përputhje me praktikat më të mira, IADK është anëtare e disa rrjeteve dhe shoqatave, qofshin ato ndërkombëtare apo lokale. Këto rrjete/shoqata përfshijnë:

- **HollanDoor** - Trajnuesit e departamentit të përpunimit të ushqimit dhe teknolog të fabrikave të qumështit janë trajnuar për prodhimin e kosit dhe djathit gjysmë të fortë nga ekspertë të PUM.
- **Senior Experten Service (SES)** - ngritja e kapaciteteve në sistemin e arsimimit dual të departamentit të përpunimit të ushqimit në përpunimin e frutave dhe perimeve dhe qumështit nga ekspert të SES.
- **Forumi Evropian për Shërbimet Këshillimore Bujqësore dhe Rurale (EUFRAS)** është një rrjet evropian dhe shoqatë përfaqësuese e shërbimeve publike dhe private të zgjerimit rural dhe bujqësor e themeluar në vitin 2013. IADK është anëtare e EUFRAS që nga viti 2016.

- **Rrjeti i Shërbimeve Këshillimore të Evropës Juglindore - SEASN** është rrjet i shërbimeve këshillimore bujqësore, odave bujqësore, instituteve bujqësore, fakulteteve dhe OJQ-ve i themeluar në Bullgari në vitin 2015.

- Në Kosovë, IADK është anëtare e Platformës CiviKos dhe Rrjetit të Grave të Kosovës.



Përmbledhje e të dhënave për të ardhurat financiare

Shpenzimet/Të Hyrat e IADK-së nga grantet për vitin 2022


No.	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	Bread for the World	Përmirësimi i punësimit dhe	250,538	29%
	Komunat (Vushtrri, Skenderaj)	mundësive për gjenerim të të ar-	16,800	
	Përfituesit e projektit	dhurave në zonat rurale të Kosovës	11,210	
2	Këshilli Danez për Refugjatë	Mbështetja e Ndërmarrësisë Shoqërore dhe Promovimi i Fuqizimit Social-ekonomik në Komunitetet Minoritare në Kosovë	55,676	6%
3	Këshilli Danez për Refugjatë	Fuqizimi i qendrës së riciklimit në lagjen e Romëve në Mitrovicën Jugore	91,506	10%
4	Këshilli Danez për Refugjatë	Fuqizimi i qendrës së riciklimit në lagjen e Romëve në Mitrovicën Jugore	8,669	1%
5	Organizata Feministe e Paqes-CFD	Fuqizimi i të rinjve dhe grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në bujqësi dhe përpunim të ushqimit	96,009	12%
	Komunat (Vushtrri, Mitrovicë)		12,522	
	Përfituesit e projektit		7,235	
6	Bashkimi Evropian, skema nderkufitare Kosove - Mali i Zi	Krijimi i punësimit në bujqësi	10,292	1%
7	Bashkimi Evropian, skema nderkufitare Kosove - Mali i Zi	Tranushumanca - ofertë e re turistike e Kosovës dhe Malit të Zi	74,162	8%
8	Zyra e Bashkimit Europian në Kosovë Përfituesit e projektit	Mbështetja e punësimit të të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë	178,085	21%
			22,530	
9	GIZ	Promovimi ekonomik për të stabilizuar tregun e punës	49,320	5%
10	FAO	Vlerësimi i bujqësisë digjitale, gjinisë dhe të rinjve për gjithëpërfshirje ekonomike në zonat rurale të Kosovës	44,900	5%
11	FAIRshare	Dixhitalizimi i Shërbimit Këshillimor Bujqësor	13,942	1%
12	USAID	Rritja e zhvillimit të aftësive në sektorin e përpunimit të ushqimit në Kosovë	3,588	0%
Total			946,533	100%

Shënim : Të dhënat janë paraqitur mbi shpenzimet e bëra për vitin 2022, ndërsa të hyrat janë njohur në raport me shpenzimet e bëra referuar projekteve.

Përmbledhje e të dhënave për të ardhurat financiare

Të hyrat e IADK-së nga shërbimet për vitin 2022

No.	Emri i Partnerit	Emri i Projektit	Shuma €	Përqindja %
1	EPI Centar	Mbështetje Teknike për Bujqësinë në Kosovë në kontekstin e Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore	47,872 €	39.72%
2	Swisscontact Kosovo	Shërbimet Këshillimore	18,580 €	15.42%
3	SOWI Kosovo	Dizajnimi dhe zbatimi i programit të rivendosjes së mirëqenjes	18,000 €	14.94%
4	Caritas Switzerland	Zhvillimi i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës ekonomik rural	24,500 €	20.33%
5	YES	Office Rent	2,772 €	2.30%
6	Komuna e Vushtrrisë, Skenderajit dhe Mitrovices	Shërbimet këshillimore dhe trajnimet për fermerë	8,797 €	7.30%
Total			120,520 €	100%



Shprehim mirënjohjen tonë për punonjësit, praktikantët dhe vullnetarët e vitit 2022

Zenel Bunjaku

Drejtor Ekzekutiv

Basri Pulaj

Kordinator i Programit & Menaxher i Projektit

Sylejman Bunjaku

Udhëheqës i departamentit të hortikulturës & Menaxheri i Projektit

Hafize Veseli

Udhëheqëse e departamentit të përpunimit & Menaxhere e Projektit

Egzon Gërxhaliu

Menaxher i Projektit

Edita Mahmuti Mula

Menaxhere e Projektit

Besnik Demiri

Menaxher i Projektit

Blerta Kuçi

Menaxhere e Projektit

Jehona Drevinja

Zyrtare e Prokurimit & dhe Administratës

Antigona Krasniqi

Zyrtare e Prokurimit & dhe Administratës

Arlindë Hyseni

Menaxhere e Financave

Ardian Jashari

Menaxher i Financave

Egzona Hajra

Inxhinier e Bujqësisë

Gëzim Murseli

Inxhinier i Bujqësisë

Halit Gashi

Inxhinier i Bujqësisë

Novica Markovic

Inxhinier i Bujqësisë

Leonora Hajra

Inxhinier e Blegtorisë

Hasan Cena

Inxhinier i Teknologjisë Ushqimore

Albesa Beqiri

Inxhinier e Teknologjisë Ushqimore

Shemsi Pllana

Inxhinier i Teknologjisë

Gonxhe Dobroshi

Zyrtare e Projektit

Esra Kurshumlija

Zyrtare e Projektit

Argjend Gjinovci

Zyrtar i Projektit

Elheme Shala

Asistente e Financave

Hanumshahe Zeneli

Asistente e Projektit

Petrit Koci

IT

Sadije Hasani

Mirëmbajtëse e objektit

Ferki Surdulli

Mirëmbajtës i objektit

Ilmihate Surdulli

Mirëmbajtëse e objektit

Dolorita Beqiri

Praktikante e projektit

Besarta Paci

Praktikante e projektit

Gresa Gashi

Praktikante e projektit

Clodagh Sheridan

Praktikante

Lilian Guber

Praktikante

Milla Huovinent

Praktikante

Mirënjohje

IADK është mirënjohëse për bashkëpunimin dhe partneritetin e krijuar me të gjithë aktet në drejtim të fuqizimit dhe zhvillimit të bujqësisë së Kosovës.

Donatorët dhe Partnerët:

Brot
für die Welt

cf d
Stärkt Frauen.
Öffnet Perspektiven.

**DANISH
REFUGEE
COUNCIL**



giz Deutsche Gesellschaft
für Internationale
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



HollandDoor
Connecting the Agroworld

CARITAS

EUFRAS



EPICENTAR
Ekipa posrednika u razvoju

P PSE
PROMOTING
PRIVATE SECTOR
EMPLOYMENT



SEASN

SES
Senior Experten Service
DER WELT EXPERTEN DIENST

skat Skills Resource Centre and
Consultancies for Development



ADRESA:

📍 Sfaraçak i Ulët, St. Miran Xhafa,
no.11, 42,000 Vushtrri, Kosovo

WEBSITE:

🌐 www.iadk.org

KONTAKTI:

☎ +383 49 777 046 / +383 44 777 036

✉ info@iadk.org

MEDIAT SOCIALE:

📘 facebook.com/iadk.org

🌐 <https://www.linkedin.com/company/iadkorg>

📺 <https://www.youtube.com/@iadk8611>



Për më shumë
MË SKENO

*Të jetojmë nga toka
dhe puna jonë!*